



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 9121, datë 28.10/2009



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr. prot. 2617, datë 28/10/2009

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më datë 28.10.2009, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, përfaqësuar nga **Prof. Dr. Fatos Harizaj**, Rektor i Universitetit, me adresë: Kodër Kamëz, këtu e në vijim i quajtur "**Fakulteti**".

Bashkia e Tiranës, përfaqësuar nga **Z.Edi Rama**, Kryetar i Bashkisë, me adresë: Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", këtu e në vijim e quajtur "**Bashkia**";

Nisur nga shqetësimi për fenomenin e qenve endacake, të cilët përbëjnë një problem serioz për komunitetin e qytetit të Tiranës, me synim administrimin e kësaj situate, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është krijimi i një qendre të specializuar për qentë endacakë, që do ketë në fokus kryesor administrimin e tyre.

Neni 2 Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin midis palëve në drejtim të krijimit të një shërbimi të profesionalizuar për qentë endacake në qytetin e Tiranës me qëllim minimizimin e rrezikut nga zoonozat.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar), neni 10, pika 1 dhe pika 3/III/d, si dhe në ligjin nr. 9308, datë 4.11.2004 për "Shërbimin dhe inspektoratin veterinar" (i ndryshuar).

1

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

4.1. Fakulteti merr përsipër:

- a- Të ofrojë godinën për krijimin e qendrës së trajtimit të kafshëve, në ambientet e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, e cila përfshin klinikën veterinarë dhe vendqëndrimin e qenve.
- b- Të administrojë qendrën nga një staf i specializuar, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
- c- Të raportojë periodikisht pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit Urban, për problemet që dalin gjatë procesit të punës.
- d- Të menaxhojë donacionet për qendrën, pas vitit të parë të projektit e në vazhdim.

4.2. Bashkia merr përsipër:

- a- Të financojë rikonstrukcionin e godinës së ofruar nga Fakulteti.
- b- Të ofrojë realizimin e fushatave sensibilizuese.
- c- Të ofrojë mjetin për transportimin e qenve në qendër dhe anasjelltas.
- d- Të ofrojë stafin e punonjësve për kapjen e qenve si dhe transportimin e tyre.
- e- Të financojë bazën materiale për periudhën 1 (një) vjeçare të projektit.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është 3 (tre) vjet, duke nisur nga data e hyrjes në fuqi të saj. Ky afat mund të zgjatet, nëse palët bien dakord për rinovimin e saj.

Neni 6
Zbatimi i marrëveshjes

6.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

6.2 Palët nënshkruese, duke marrë në konsideratë faktorë dhe probleme të reja që mund të dalin gjatë periudhës së mësipërme, në mirëkuptim të përbashkët, mund të ndyshojnë dhe plotësojnë marrëveshjen.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e miratimit të fondeve nga Këshilli Bashkiak për fillimin e rikonstrukcionit të godinës së ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare

dhe financimin e bazës materiale gjatë vitit të parë të projektit. Marrëveshja hartohet në 4 (katër) kopje identike, nga 2 kopje për secilën palë.

* * *

Bashkia e Tiranës

Z. Edi Rama

Kryetar



Universiteti Bujqësor i Tiranës

Prof. Dr. Fatos Harizaj

Rektor



[Handwritten signatures]